

**NEON A.S**

RR.XHANFISE KEKO, ND.168 , H.1, CP. 1005

TIRANA, ALBANIA

TEL: +355 42 377 773

FAX:: +355 42 347 770

E-MAIL: INFO@NEON.AL WEB: WWW.NEON.AL**NEON RS RELIEF**

(BOJE DEKORATIVE PER FASADA)

Skedë Teknike

PËRSHKRIMI: RS RELIEF është një bojë dekorative e shkëlqyer, e bardhë e destinuar për lyerje muri të brendshëm dhe të jashtëm, që përveç rezinave dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushës, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë dioksid titani, karbonat kalciumi, heksametafosfat natriumi, hidroksietilcelulozë, izotiazolinon, poliksiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, si edhe një përbërës të fortë antimyku, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, dhe në kushte normale, boja thahet 4 - 5 orë pas aplikimit, duke formuar një sipërfaqe të fortë, të ashpër, elastike e cila rezistencë të lartë dhe qëndrueshmëri ndaj agjentëve atmosferikë.

Tharja e plotë bëhet pas 2 ose 3 ditësh.

FUSHA E PËRDORIMIT: RS RELIEF është e përdorshme për mjedise të brendshme (mure) si dhe për mjedise të jashtme, për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni, për ti veshur ato me një shtresë dekorative.

NGJYRA: E bardhë.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra), dhe sidomos nga myku që mund të ketë sipërfaqja që do të bojatiset.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar RS RELIEF.

Kalojmë dorën e parë duke e holluar me ujë në raportin 3:1. Mbas tharjes së dorës së parë kalojmë dorën e dytë pa e holluar me ujë. Dorën e dytë e aplikojmë me furçë ose me shpatull. Në fund kalojmë sipërfaqen me rrul për të përfutur ashpërsinë e dëshiruar.

Në kushte normale sipërfaqja e lyer thahet pas 4 – 5 orë. Ndërsa tharja e plotë pas 2-3 ditësh. Është i rezistueshëm në kushte të vështira atmosferike dhe në mënyrë elastike ndjek sipërfaqen ku aplikohet. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul, furçë ose shpatull.

NGJYRIMI: RS RELIEF është e përshtatshme për të krijuar një gamë të gjërë bojrash me ngjyrë, duke përdorur 9 bazat ngjyruese NEON UNO COLOR PAINT dhe 9 bazat ngjyruese NEON RS COLOR PAINT.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të

mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5⁰C.
Pas përfundimit të lyerjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra..... e bardhë
- Koha e tharjes..... 4 – 5 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC. Megjithatë kontakti me acidet dhe në temperatura mbi 800⁰C, bën që të çlirohet dioksid karboni.

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kova plastike 3L, dhe 9L.